



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin

Qershor, 2020

Ministri Likaj u takua me përfaqësues të SBASHK-ut Përkushtim i përbashkët në shërbim të arsimit




Ministri i MASHTI-t Ramë Likaj me anëtarë të Kabinetit të tij ka pritur në një takim njohës kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatorin për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut e kanë përgëzuar Ministrin Likaj për detyrën duke shprehur gatishmërinë për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit dhe në zgjidhjen e kërkesave legjitime të të punësuarve në këtë ...(faqe 4)

Numër i madh i mësimdhënësve pjesë e trajnimeve të licencuara të SBASHK

Në realizim të motos për të mësuarit gjatë gjithë jetës



Krahas angazhimeve të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së ...(faqe 8)

Edhe një takim nga larg i EI me sindikatat anëtare

Në mbështetje të institucioneve për shkollat e sigurta për të gjithë



Internacionalja Botërore e Arsimit (EI) ka ...(faqe 10)

Intervistë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri


Edhe në këto rrethana angazhime të mëdha në shërbim të anëtarësisë



Krahas detyrave të shumta ka bërë me sukses ...(faqe 3)

Në qershor vazhduan së realizuari takimet nga larg

Analizë e arritjet, u caktuan detyra konkrete për të ardhmen



Në pjesën e parë të qershorit stafi qendror i SBASHK-ut ka vazhduar së realiz...(faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Mësimdhënësit e Kosovës edhe një herë lartësuan figurën e mësuesit



Pjesa e parë e vitit 2020 ishte shumë sfiduese për arsimin, por edhe për shtetin tonë e tërë botën. Mësimi filloi mbarë pas pushimeve të dimrit dhe punëtorët e arsimit po shtonin mobilizimin për arritje të reja në njërën anë dhe në anën tjetër po prisnin vërdiktin e Kushtetueses lidhur me Ligjin e pagave. Kushtetuesja mori vendim për pezullimin e parë të ligjit bazuar në kërkesën e Avokatit të popullit. Në pritje të këtij vërdikti e duke bashkëpunuar me sindikata tjera SBASHK-u po angazhohej që të dëgjohej zëri i mijëra të punësuarve në sektorin publik dhe që pezullimi të merrte fund me

një vendim merititor. Kjo nuk ndodhi dhe sfidat filluan të shtoheshin. Kosova, sikur gjithë vendet e botës u prek nga një armik, që nuk duhej, por që po sillte vuajtje e vdekje. Kjo situatë bëri që të mbyllen institucionet arsimore dhe duhej mobilizim shtesë për të filluar me një metodë mësimi, që për shumicën e punëtorëve të arsimit në Kosovë e madje edhe në botë ishte sfiduese. Filloi mësimi në distancë dhe punëtorët e arsimit sfidat i përballuan me vullnetin e çeliktë dhe me përkushtimin shembullor. SBASHK-u gjatë gjithë kohës vazhdojë komunikimin me veprimtarët sindikal në shkolla, njësi akademike dhe me kryetarë të nivelit komunal e të Universiteteve duke mbështetur ata në misionin e tyre të vështirë për realizimin e mësimi në distancë. Përgëzimet e SBASHK-ut për të gjithë punëtorët e arsimit në Kosovë, sepse ishin në krye të misionit të tyre të shenjtë në arsimimin dhe edukimin e brezave.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org


Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Edhe në këto rrethana angazhime të mëdha në shërbim të anëtarësisë



Krahas detyrave të shumta ka bërë me sukses edhe koordinimin e aktiviteteve të shumta të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Një aktivitet i veçantë, që ka kërkuar angazhime të mëdha është edhe organizimi nga larg i

trajnimeve të licencuara të SBASHK-ut sepse kërkesat ishin shumë të mëdha dhe duhej mobilizim e përkushtim, jo vetëm në ditët e punës, por edhe gjatë gjithë vikendeve. Për këto dhe aktivitetet tjera për gazetën tonë flet koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.

Arsimimi sot:

SBASHK-u vazhdoi me shumë aktivitete edhe në kohë pandemie, sa ishte e vështirë kjo?

Ymeri:

Edhe në të kaluarën, por edhe sot e gjithmonë, SBASHK-u nuk i ka ndaluar angazhimet në shërbim të anëtarësisë. Vepruam dhe ishim pranë punëtorëve të arsimit e në shërbim të mbrojtjes së shkollës shqipe në kohët e pushtimit dhe ia dolëm me mund e sakrificë. U mobilizuam dhe me mund e sakrificë punëtorët e arsimit i dhanë rrjedhë të mbarë procesit mësimor nga larg duke e përmbysur me sukses vitin mësimor. SBASHK-u gjatë gjithë kohës ka mbajtur takime nga larg me Këshillin Drejtues, me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të Universiteteve dhe bashkë me ta ka organizuar dhjetëra takime nga larg me kryetarët e shoqatave sindikale të institucioneve të Arsimit parauniversitar dhe të njësive akademike të Universiteteve të Kosovës duke i dhënë mbështetje e kurajë kolegëve tanë kudo në Kosovë që të vazhdojnë me angazhimet në shërbim të rrjedhës së mbarë të procesit arsimor nga larg. Po ashtu kemi shtuar angazhimet në stafin qendror për të realizuar gjithë kërkesat e kolegëve tanë për organizimin e trajnimeve të licencuara dhe tani kur kemi analizuar rrjedhën e këtij aktiviteti shihet se arritjet janë shumë të larta dhe për këtë meritë janë stafi qendror, trajnerët e nderuar, kryetarët e niveli komunal, por edhe mësimdhënësit pjesëmarrës në gjithë këto trajnime.

Arsimimi sot:

Thatë se janë shënuar arritje të larta me organizimin e trajnimeve të licencuara, na tregoni diçka më shumë lidhur me këtë aktivitet të veçantë.

Ymeri:

SBASHK-u ka aplikuar në Këshillin Shtetëror të Licencimit të Mësimdhënësve për pesë trajnime me qëllim që t'gjendemi afër kolegëve tanë që ata të marrin njohur të reja, që do t'i përdorin në procesin mësimor në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë, por edhe që të arrijnë numrin e orëve të kërkuara të trajnimeve për licencën e punës, apo edhe për procesin e gradimit, që pritet të nis në sistemin arsimor të Kosovës. Këto trajnime i kemi mbajtur në të kaluarën në ambiente të institucioneve arsimore, por situata ndryshoi shumë dhe institucionet u mbyllën nga shkak i pandemisë. Kështu ne duke marrë shumë kërkesa nga anëtarësia për trajnimet, shtuam angazhimet dhe në koordinim me trajnerët, që i falënderoj shumë për gatishmërinë dhe angazhimin filluam me trajnimet nga larg. Volumi i punës ishte shumë i madh, por bashkërisht e me angazhim e përkushtim e të gjithë të angazhuarve ia dolëm ta përmbysim këtë cikël të trajnimeve me plot sukses. Urojmë që trajnimet në të ardhmen t'i vazhdojmë në ambientet e institucionet tona arsimore kudo në Kosovë.

Arsimimi sot:

Këtë punë kaq me përkushtim dhe këto arritje kaq të mëdha në organizimin e trajnimeve si duken në shifra?

Ymeri:

Po. Këtë që thash për trajnimet dëshmohen me shifra konkrete. SBASHK-u ka organizuar 4 trajnime nga larg, nga 5 trajnimet e licencuara. Janë organizuar trajnimet "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social", i konceptuar në 32 orë trajnim, "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", në 28 orë, "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik", në 32 orë dhe "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm", i konceptuar në 32 orë trajnim.

Në trajnimin nga larg, "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik", kanë marrë pjesë dhe e kanë përfunduar me sukses 560

mësimdhënës nga komuna të ndryshme të Kosovës. Trajnimin nga larg "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" e kanë përfunduar 673 mësimdhënës, Trajnimin nga larg "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" e kanë përfunduar me sukses 432 kolegë e kolege, ndërsa trajnimin nga larg "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" e kanë përfunduar 339 punëtorë të arsimit. Jemi angazhuar shumë i gjithë stafi qendror bashkë me trajnerët dhe kryetarët e nivelit sindikal komunal, por ia vlen sepse arritjet janë të mëdha dhe për këtë kemi marrë shumë përgëzime e falënderime nga anëtarësia

e SBASHK-ut dhe kjo është forca që na mobilizon e forcon për angazhime të vazhdueshme në shërbim të anëtarësisë.

Arsimimi sot:

Për angazhimet dhe arritjet tjera do të bashkëbisedojmë për ndonjë numër tjetër të gazetës sonë, çfarë do të shtonit në fund të kësaj interviste?

Ymeri:

SBASHK-u gëzon mbështetjen, përkrahjen dhe besimin e plotë të anëtarësisë. Kjo na jep forcë dhe na obligon që të angazhohemi pa u ndalur në realizimin e kërkesave të tyre. Është kënaqësi e krenari të jesh në shërbim të anëtarësisë së SBASHK-ut.

Gjatë muajit

Ministri Likaj u takua me përfaqësues të SBASHK-ut

Përkushtim i përbashkët në shërbim të arsimit

Ministri i MASHTI-t Ramë Likaj me anëtarë të Kabinetit të tij ka pritur në një takim njohës kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatorin për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut e kanë përgëzuar Ministrin Likaj për detyrën duke shprehur gatishmërinë për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit dhe në zgjidhjen e kërkesave legjitime të të punësuarve në këtë sektor me rëndësi.



Ministri Ramë Likaj ka vlerësuar angazhimin dhe përkushtimin e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe të arsimit në përgjithësi duke shtuar se MASHTI e konsideron SBASHK-un partner të rëndësishëm dhe se bashkërisht e me dialog do të angazhohen për

realizimin e kërkesave të drejta e legjitime të anëtarësisë, por edhe në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim. Ministri Likaj është shprehur se përfaqësuesit e SBASHK-ut do të jenë të përfshirë në të gjitha komisionet dhe grupet e punës për të dhënë kontributin e tyre në përgatitjen e akteve e dokumenteve tjera në shërbim të realizimit të objektivave në shërbim të një arsimit sa më cilësor.

Kryetari Jasharaj dhe koordinatori Ymeri kanë informuar Ministrin Likaj për përkushtimin e SBASHK-ut në komunikim me anëtarësinë në shërbim të rrjedhës së mbarë të mësimin nga larg. Ata po ashtu kanë njoftuar Ministrin edhe për trajnimet që SBASHK-u vazhdon t'i organizojë nga larg duke realizuar kështu kërkesat e qindra punëtorëve të arsimit.


Gjatë këtij takimi njohës delegacioni i SBASHK-ut ka ngritur edhe çështjen e gjetjes së një zgjidhje të pranueshme ligjore për kolegët tanë të sëmure rëndë, e që vazhdojnë të jenë pjesë e sistemit arsimor. Po ashtu janë përmendur edhe çështje të tjera të rëndësishme së veçantë, të cilat do të analizohen e do të merren veprime konkrete për realizimin e tyre në takimet e radhës mes të MASHTI-t dhe SBASHK-ut, që do të ndodhin në vazhdimësi.

Në qershor vazhduan së realizuari takimet nga larg

Analizë e arritjet, u caktuan detyra konkrete për të ardhmen




Në pjesën e parë të qershorit stafi qendror i SBASHK-ut ka vazhduar së realizuari agjendën e takimeve nga larg me Kuvendet e Sindikatës së Arsimit Parauniversitar dhe të Universiteteve. Pikërisht më 1 qershor është mbajtur takimi nga larg me anëtarët e Kuvendit të Arsimit Parauniversitar të Rahovecit. Në hapje të këtij takimi kryetari për këtë komunë Veli Morina ka përshëndetur kryetarin Rrahman Jasharaj, nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e pastaj bëri një shpalosje të aktiviteteve sindikale e arsimore në këtë komunë. Në këtë takim u analizua angazhimi i kolegëve tanë në mësimin nga larg dhe u vlerësua lartë angazhimi i tyre. Po ashtu është bashkëbiseduar për sfidat dhe angazhimet sindikale dhe pjesëmarrësit kanë përgëzuar stafin qendror për angazhimet dhe përkushtimin në shërbim të anëtarësisë. Në këtë takim është biseduar edhe për përgatitjet e SBASHK-ut lidhur me realizimin e traditës për dërgimin e një numri të konsiderueshëm punëtorësh të arsimit në bregdetin shqiptar. Është thënë se përgatitjet do të bëhen me kohë, ndërsa realizimi i këtij aktiviteti varet nga situata e krijuar aktuale krijuar nga Covid 19.



Atmosferë pune e uniteti ishte edhe në takimin nga larg të Kuvendit të Arsimit Parauniversitar për komunën e Kastriotit (Obiliqit). Në hapje të këtij

takimi kryetarja për këtë komunë Luljeta Boshnjaku ka falënderuar stafin qendror për pjesëmarrje dhe pastaj ka bërë një analizë të angazhimeve sindikale në nivelin lokal e qendror për të kaluar pastaj në bashkëbisedë me pjesëmarrësit, në pyetjet e të cilëve janë përgjigjur kryetari Jasharaj dhe anëtarë të stafit qendror.




Agjendë e ngjeshur e takimeve ishte edhe më 3 qershor. Në këtë ditë janë mbajtur disa takime të ndara me Kuvendet Sindikale të Arsimit Parauniversitar.

U fillua me takimin nga larg me Kuvendin e Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Fushë Kosovës. Në hapje të këtij takimi kryetari për këtë komunë Selim Krasniqi bëri një shpalosje të aktiviteteve sindikale të nivelit komunal duke lavdëruar angazhimet e vazhdueshme dhe përkushtimin e stafit qendror në realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Ai pas kësaj ka informuar pjesëmarrësit se në takimin e kaluar konsultativ me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve është vendosur të që të mbahen takime nga larg me Kuvendet sindikale komunale dhe të Universiteteve dhe të debatohet për organizimin e pushimeve në bregdetin shqiptar dhe për rrjedhën e trajnimeve të nisura dhe për mundësinë e organizimit të trajnimeve të reja. Po këtë ditë u mbajt takimi nga larg me kolegët tanë nga Drenasi. Kryetari i Kuvendit Sindikal për Arsimin

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës


Parauniversitar për këtë komunë, Ilaz Dervishaj ka përshëndetur stafin qendror të SBASHK-ut dhe pjesëmarrësit dhe pastaj ka bërë një vlerësim të aktiviteteve sindikale dhe të angazhimit të kolegëve tanë në komunën e Drenasit në shërbim të rrjedhës së mbarë të mësimit në distancë. Edhe në këtë takim u zhvillua bashkëbisedë me pjesëmarrësit për çështje arsimore e sindikale.



Më 3 qershor janë mbajtur edhe takimet nga larg me Kuvendet Sindikale të Arsimit Parauniversitar të komunës së Malishevës dhe të Shtimes. Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Malishevës, Skënder Gashi ka bërë një analizë të situatës aktuale në arsimin e kësaj komune dhe ka vlerësuar lart angazhimin e kolegëve tanë atje në rrjedhën e mësimit në distancë. Gashi ka përgëzuar stafin qendror të SBASHK-ut për angazhimin, përkushtimin dhe arritjet e vazhdueshme në realizimin e kërkesave të anëtarësisë.



Në takimin tjetër nga larg me kolegët tanë nga komuna e Shtimes kryetari për këtë komunë Xhavit Rexhaj ka bërë një vlerësim të aktiviteteve sindikale në këtë komunë dhe të angazhimit të vazhdueshëm të kolegëve tanë për realizimin me sukses të mësimit në distancë. Agjenda e takimeve për këtë ditë është përmbyllur në orët e mbrëmjes me takimin nga larg me Kuvendin e Sindikatës së Arsimit parauniversitar të Lipjanit. Në hapje të këtij takimi kryetari për këtë komunë Emrush Ahmeti ka bërë një analizë të aktiviteteve të zhvilluara në nivelin komunal në koordinim me nivelin qendror dhe ka shprehur respekt për gjithë përkushtimin e madh të stafit qendror në përpjekje për të realizuar kërkesat e anëtarësisë.




Në të gjitha këto takime nga larg të mbajtura më 3 qershor është zhvilluar një bashkëbisedë me pjesëmarrësit dhe janë debatuar çështjet aktuale duke u ndalur edhe te organizimi i pushimeve në bregdetin shqiptar, lidhur me përgatitjen e Kontratës së re Kolektive për Arsimin e Kosovës dhe për çështje të tjera. Në pyetjet e pjesëmarrësve në gjithë këto takime janë përgjigjur kryetari, nënkryetarja dhe koordinatori për organizim të brendshëm i SBASHK-ut.




Një varg takimesh nga larg edhe të enjten e 4 qershorit

Bashkërisht në përballje me sfidat dhe në realizimin e detyrave



Agjenda e takimeve nga larg ka vazhduar edhe më 4 qershor. Këtë ditë janë mbajtur takime të ndara me kolegët tanë nga Vushtrria, Kaçaniku, Vitia, Kamenica dhe Prizreni. Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vushtrrisë Alush Maloku në hapje të takimit ka përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut, nënkryetaren Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe gjithë stafin qendror duke i përgëzuar për angazhimet dhe përkushtimin. Pas kësaj është zhvilluar bashkëbisedë për gjendjen aktuale në arsim dhe për detyrat konkrete të SBASHK-ut në nivelin qendror e lokal.




Një atmosferë përkushtimi në angazhimet sindikale është vërejtur edhe në takimin nga larg të Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Kaçanikut. Kryetari për këtë komunë Fevzi Bunjaku ka falënderuar kryetarin Jasharaj dhe anëtarë të stafit qendror për kyçje në këtë takim dhe për gjithë angazhimet e aktivitetet që po zhvillojnë në shërbim të anëtarësisë. Ai pastaj ka bërë një vlerësim të aktiviteteve sindikale në këtë komunë. Edhe në këtë takim është bashkëbiseduar për organizimin e pushimeve për një numër të konsideruar të anëtarëve të SBASHK-ut në bregdetin shqiptar për për për

angazhimet e aktivitetet në vijim. Koordinatori për organizim të brendshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri u është përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve në këtë takim.



Agjenda ka vazhduar me takimin nga larg me kolegët tanë nga komuna e Vitisë. Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Kemajl Bislimi ka bërë një shpalosje të aktiviteteve sindikale në këtë komunë dhe ka treguar edhe për vazhdimin e përkushtimit të kolegëve tanë atje në rrjedhën e mbarë të mësimit në distancë. Edhe kryetari Bislimi ka lavdëruar angazhimin e përkushtimin e stafit qendror të SBASHK-ut dhe ka treguar edhe për detyrat që kanë dalë nga takimi konsultativ me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Takime të ndara nga larg po të enjten kanë mbajtur edhe Kuvendet e Sindikatës së arsimit parauniversitar të Kamenicës e Prizrenit.




Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit parauniversitar për Kamenicën Nazim Jakupi ka folur për angazhimet momentale sindikale në këtë komunë dhe ka lavdëruar punën e përkushtimin e stafit qendror

e pastaj ka nisur me bashkëbisedën lidhur me detyrat që janë përcaktuar të debatohen në takimet e Kuvendeve komunale sindikale dhe të Universiteteve. Po edhe në takimin nga larg të Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Prizrenit është zhvilluar një bashkëbisedë për aktivitete e zhvilluara deri tanë në nivelin komunal dhe atë qendror e po ashtu është debatuar edhe për detyrat konkrete në vijim të aktiviteteve sindikale duke veçuar përgatitjet që kanë nisur me kohë lidhur me organizimin e pushimit për më shumë se 400 kolegët tanë nga e tërë Kosova në bregdetin shqiptar, që do të përzgjidhen nga shkollat dhe institucionet arsimore sipas radhës dhe marrëveshjes së arritur pikërisht në takimet e Kuvendeve sindikale. Kryetari për këtë komunë Reshit Kushaj ka vlerësuar bashkë me pjesëmarrësit aktivitetet sindikale në nivelin komunal e atë qendror dhe ka përgëzuar stafin qendror për angazhimet. Në pyetjet e pjesëmarrësve është përgjigjur nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala. Mbrëmja e së enjtes është përmbyllur me dy takimet e radhës. Është mbajtur takimi i Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve dhe ai i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Gjilanit.

Në hapje të takimit me anëtarët e Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve, kryetari Bardh Bardhi ka përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, nënkryetaren Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe përfaqësuesit në këtë Kuvend të Universiteteve të Kosovës. Ai pas kësaj ka prezantuar angazhimet që janë bërë nga stafi akademik dhe ai administrativ në realizimin e procesit mësimor e studimor nga larg duke vlerësuar se që nga fillimi ka qenë një angazhim e përkushtim i lartë dhe prandaj edhe sukses janë të

dukshme. Pas kësaj kryetari i SBASHK-ut ka përshëndetur pjesëmarrësit duke i përgëzuar për punën e përkushtimin e mandej i ka informuar edhe angazhimet aktuale dhe për detyrat konkrete në vijim. Kryetari bashkë me përfaqësuesit e tjerë nga stafi qendror kanë falënderuar prof. dr. Azem Kyçyku për angazhimin dhe kontributin e tij me vlerë rreth Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës. Pas kësaj është kaluar në shpalosjen e rendit të punës sipas marrëveshjes nga takimi konsultativ me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve.

Në përmbyllje të agjendës së takimeve për këtë ditë është mbajtur takimi nga larg me anëtarët e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Gjilanit. Në hapje të këtij takimi kryetari i këtij Kuvendi Blerim Mehmeti ka përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut, nënkryetaren, koordinatoren dhe gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi e pastaj ka bërë një analizë të aktivitetit sindikal e arsimor në këtë komunë, por edhe ka vlerësuar lart angazhimet sindikale të stafit qendror në realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Në të gjitha këto takime pjesëmarrësit kanë shtruar edhe pyetje konkrete në të cilat janë përgjigjur nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.



Numër i madh i mësimdhënësve pjesë e trajnimeve të licencuara të SBASHK

Në realizim të motos për të mësuarit gjatë gjithë jetës




Krahas angazhimeve të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së kufizimeve për arsye të pandemisë në realizimin e mësimit nga larg, një numër shumë i

madh i mësimdhënësve nga komuna të Kosovës kanë nisur në SBASHK kërkesa përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal për të organizuar të katër trajnimet e licencuara. Këto kërkesa janë shqyrtuar me kujdes nga stafi qendror i SBASHK-ut dhe pastaj janë mbajtur takime konsultative me trajnerët e licencuar,

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës


të cilët janë shprehur të gatshëm për angazhim e përkushtim me qëllim të rrjedhës së mbarë të këtij aktiviteti me rëndësi. Pasi janë krijuar kushtet e duhura është nisur edhe me trajnimet nga larg , që u mbajtjen zakonisht në ditë të vikendeve, pasi në ditët tjera mësimdhënësit ishin shumë të angazhuar në mësimin në distancë, për çka SBASHK-u ka shprehur vazhdimisht respekt meritore. Trajnimet janë organizuar gjatë vikendeve e ditëve, po edhe në ditët tjera varësisht nga marrëveshja mes trajnerëve dhe pjesëmarrësve në trajnime.





U nis me kolegët tanë nga komuna e Novobërdës dhe pasi trajnimet ishin organizuar mirë dhe kishin përfundim shumë të suksesshëm janë shtuar kërkesat e kolegëve tanë për të marrë pjesë në trajnimet "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social", që është i konceptuar në 32 orë, "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", 28 orë "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik", 32 orë dhe në trajnimin "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" të konceptuar në 32 orë. Kishte kërkesa edhe për trajnimin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", i konceptuar në dy pjesë me 51 dhe 53 orë të trajnimit efektiv, por është vendosur që të shtohet mobilizimi dhe të punohet në krijimin e kushteve shtesë pasi është trajnim që kërkon kushte të veçanta për t'u realizuar në tërësi dhe me sukses.

Nga raportet lidhur me pjesëmarrjen në këto katër trajnime që janë organizuar me kërkesën e kolegëve tanë nga shumë komuna të Kosovës shihet se interesim i madh ka qenë për secilin nga këto trajnime dhe vetë shifra prej 2004 pjesëmarrësve në to e dëshmon këtë. Këto trajnime në distancë ishin

moment i mirë edhe për bashkëbiseda me anëtarësinë pjesëmarrëse në këtë aktivitet. Kështu në gjithë këtë aktivitet ishin të kyçur kohë pas kohe edhe kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala , koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri , zyrtarja për trajnime Albina Ahmeti , por edhe gjithë stafi qendror i SBASHK-ut. Pjesëmarrësit e gjithë këtyre trajnimeve kanë përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe përkushtimin në shërbim të anëtarësisë dhe kanë bashkëbiseduar e kanë shtruar pyetje konkrete për çështje arsimore e sindikale.



Zyra për informim e SBASHK-ut vazhdimisht e me kujdes ka përcjellë këtë aktivitet dhe ka informuar lexuesit për rrjedhën e të gjitha trajnimeve në ueb faqen e SBASHK-ut dhe rrjetet sociale.






I tërë ky aktivitet nuk do të kryhej me kaq sukses sikur të mos ishte përkushtimi vazhdueshëm i stafit qendror, veçmas i koordinatorëve të trajnimeve Vjollca Shala e Ymer Ymeri, i kryetarëve të nivelit komunal, por edhe i trajnerëve, të cilët e kishin mbajtur në përpikëri premtimin e dhënë se do të angazhohen me tërë mundësitë e tyre për rrjedhën e mbarë të trajnimeve në të cilat janë angazhuar. SBASHK-u shpreh publikisht respekt meritore për përkushtimin dhe angazhimin e trajnerëve Blerta Blakaj, Sami Shala, Alban Zeneli, Dren Gërguri, Kastriot Veselaj, Blendor Shatri, Mentor Mani, Blerim Mehmeti e Emrush Ahmeti, Arbëresha Aliu, Atdhe Hykolli, Skënder Gashi, Besim Kryeziu, Hysen Sogojeva dhe Ilir Gashi, Arbenitë Hoxha, Jehona Oruçi, Besa Hoxha Krasniqi, Fidan N. Shaqiri e Safet Beqiri, Arbëresha Aliu e Pranvera Haziri, Fidan Shaqiri dhe të tjerët, të cilët me zell kanë shpërndarë pa hezitim dijet e tyre te pjesëmarrësit e madje duke i nxitur që të jenë sa më aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimeve.

Edhe një takim nga larg i EI me sindikatat anëtare



Në mbështetje të institucioneve për shkollat e sigurta për të gjithë

Internacionalja Botërore e Arsimit (EI) ka mbajtur takimin e radhës nga larg me përfaqësues të sindikatave anëtare nga e tërë bota në kohën kur në shumë shtete të botës pas një kohe të gjatë është filluar me masa lehtësuese. Në hapje të këtij takimi të rëndësishëm, kryetarja e EI-së ka përshëndetur përfaqësuesit e sindikatave nga e tërë bota dhe pastaj ka bërë një vlerësim të gjendjes aktuale në arsimin në nivel botëror duke kujtuar se pandemia ka ndikuar dhe vazhdon të ketë ndikim në sistemet arsimore, punëtorët e arsimit dhe të nxënësit e studentët në tërë botën.

Këtë takim nga largësia e hapi Presidentja e EI-së znj. Susan Hopgood e cila fillimisht përshëndeti të pranishmit në takim.



E premtja e 26 qershorit ka shënuar fillimin edhe të 10 grupeve të ndara për trajnimet e licencuara, të cilat kanë vazhduar gjatë ditëve të vikendit dhe në ditën e hënë e të martë. Këto 10 grupe shënojnë përmbylljen e këtij cikli të trajnimeve dhe në to janë paraqitur të marrin pjesë 493 pjesëmarrës nga komuna të ndryshme të Kosovës. SBASHK-u me të afruar të vitit të ri shkollor do të rinis me këtë aktivitet me urimin dhe shpresën që trajnimet të zhvillohen në ambientet e institucioneve tona arsimore.




“Sipas UNESCO, pandemia ndikon aktualisht gati në 70% të popullsisë studentore në botë. Në kulmin e saj, disa javë më parë, pandemia kishte prekur më shumë

se 90% të popullsisë globale të studentëve , gjegjësisht, më shumë se 1.5 miliardë studentë dhe 63 milion mësues. Me gjithë kërcënimin e vazhdueshëm të pandemisë, shumë vende dhe juridiksione kanë filluar të heqin masat e kontrollit dhe të rihapin shkollat dhe institucionet e tjera arsimore. Vendimi për rihapjen e institucioneve arsimore vendos një përgjegjësi të madhe mbi supet e shkollës dhe drejtuesve të tjerë të arsimit, të cilët pritet të sigurojnë, jo vetëm cilësinë e mësimdhënies dhe mësimin, por edhe shëndetin dhe sigurinë e nxënësve, mësuesve dhe personelit mbështetës të arsimit” ka vlerësuar kryetarja e EI-së për të kujtuar edhe një herë gjashtë konditat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e që janë: Angazhimi në Dialog Social dhe Politik, Sigurimi i Shëndetit dhe Sigurisë së Komuniteteve të Arsimit, Barazia të jetë përparësia kryesore, Mbështetja e Mirëqenies fizike dhe emocionale dhe rikuperimi, Besimi në profesionalizmin e arsimtarëve.

Si gjithmonë, edhe në këtë takim të rëndësishëm nga larg morën pjesë edhe përfaqësues të SBASHK-ut.



të cilët në këtë takim nga larg ndanë me të pranishmit këto informacione:



SBASHK-u gjatë gjithë kohës së pandemisë Covid-19 ka përcjellë dhe mbështetur drejtoritë komunale të arsimit dhe udhëheqësit e shkollave të Kosovës që nxënësit dhe stafi mësimor të jenë të sigurt dhe të jenë mirë me shëndet.


“Në Kosovë janë rihapur shkollat e mesme të ulëta për nxënësit e klasave të 9-ta për ti përgatitur ata për testin e arritshmërisë. Paraprakisht janë marrë masat për parandalimin e virusit Covid-19, shkollat janë dezinfektuar dhe janë pajisur me dezinfektues, maska dhe doreza për nxënës dhe stafin mësimor. Nxënësit janë ndarë në grupe më të vogla nga 12 nxënës në një klasë. Çerdhet janë rihapur javën e kaluar, të cilat paraprakisht janë dezinfektuar dhe fëmijët janë ndarë në grupe më të vogla”, kanë informuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për gjendjen aktuale në arsimin e Kosovës. Përfaqësuesit e EI-së kanë falënderuar SBASHK-un për shkëmbimin e eksperiencës me kolegët nga vende të tjera të botës.

Të premten e 5 qershorit vazhduan takimet e ndara me kolegët tanë

Angazhim, përkushtim dhe unitet në shërbim të anëtarësisë

Agjenda e takimeve nga larg me anëtarët e Kuvendeve Sindikale të Arsimit Parauniversitar është nisur me Dragashin për të vazhduar me Klinën, Istogun, Deçanin, Mitrovicën e Skenderajn dhe me komuna të tjera deri në orët e vona të së premtes.

Në hapje të takimit me kolegët tanë nga Dragashi, kryetari i Kuvendit të Sindikatës për Arsimin parauniversitar të kësaj komune, Xhevit Skenderi ka falënderuar kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, nënkryetaren Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe gjithë



stafin qendror për angazhim dhe përkushtimin në shërbim të anëtarësisë e pastaj ka nisur me shpalosjen e rendit të punës. Atmosferë e angazhimit,

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

përkushtimit dhe unitetit në shërbim të anëtarësisë është vërejtur edhe në takimet e radhës që janë mbajtur.

Kryetarët e Kuvendeve Sindikale të Arsimit Parauniversitar të Klinës, Arif Elezi, ai i Istogut, Musli Blakaj, i Deçanit Burim Avdijaj, i Mitrovicës, Isa Ismajli dhe i Skenderajt Ramiz Polaci të takimet e ndara të kuvendeve që ata udhëheqin kanë kujtuar momente kyçe të angazhimeve sindikale në komunat e tyre dhe kanë shprehur respekt për gjithë angazhimet e stafit qendror në shërbim të anëtarësisë. Edhe në të gjitha këto takime nga larg janë kyçur kryetari Rahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri u janë përgjigjur shumë pyetjeve të pjesëmarrësve në këto takime e që kishin të bënin lidhur me Kontratën Kolektive të Arsimit, me trajnimet dhe për ystje të tjera sindikale.



Ky aktivitet nuk është ndalur për ditën e premte vetëm me këto takime, por ka vazhduar në orët e mbrëmjes

me takimet e radhës me Kuvendet e Sindikatës së Arsimit parauniversitar të Ferizajt, Pejës dhe Podujevës. Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ka folur për punën dhe përkushtimin e kolegëve tanë kudo në Kosovë në mësimin në distancë dhe për aktivitetet sindikale në nivelin qendror e atë lokal. Nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri u janë përgjigjur shumë pyetjeve të pjesëmarrësve në këto takime e që kishin të bënin lidhur me Kontratën Kolektive të Arsimit, me trajnimet dhe për ystje të tjera sindikale.

